

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por ujë 24 orë nuk ka
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/bb-shqiperia-shpenzon-mbi-nivelin-e-nevojshem-per-uj-e-kanalizime-po-i474550
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:53:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:37:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2a426f4dffa67be686130133e761cd1fa2a769ab0d1de27906c6e866bfde08b0
TEKSTI	f1fde4100e9e02d269b604e396e53e17bf333cf90aeb5038ab68b13475353250
PAMJA	14d0ed23ed1fec48472970278ae5b92c3618da9e1a09e1b4aa05b8751b189d3b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	07b90e5921f4c060aa20004335562e71372f278dfc06079fb9fc7b1587db660b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/07b90e5921f4c060aa20004335562e71372f278dfc06079fb9fc7b1587db660b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por ujë 24 orë nuk ka



18 Shtator 2026, 14:37, Aktualitet CNA



Shqipëria rezulton ndër rastet e veçanta ku shpenzimet për furnizimin me ujë dhe kanalizimet janë më të larta se niveli që vlerësohet i nevojshëm për arritjen e objektivave deri në vitin 2030, por aksesit i popullsisë në shërbime të menaxhuara në mënyrë të sigurt mbetet relativisht i ulët.

Kjo është një nga gjetjet për Shqipërinë në raportin e Bankës Botërore "Funding a Water-Secure Future: An Assessment of Global Public Spending", një analizë e shpenzimeve publike për sektorin e ujit në nivel global.

Banka Botërore ka krahasuar nivelin e shpenzimeve të vendeve me shkallën e aksesit në ujë dhe kanalizime, për të vlerësuar nëse financimet aktuale janë të mjaftueshme për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 6.1 dhe 6.2, që synojnë akses universal në ujë të pijshëm dhe kanalizime të menaxhuara në mënyrë të sigurt deri në vitin 2030.

Për kanalizimet, analiza përfshin 57 vende dhe i ndan ato sipas nivelit të aksesit dhe nëse shpenzojnë më shumë apo më pak se nevojat e llogaritura. Shqipëria bën pjesë në grupin

e vendeve me akses me te ulet se mesatarja globale, por njekohesisht me shpenzime mbi nivelin e vleresuar te nevojshem. Nga 40 vendet me akses te ulet, vetem Shqiperia, Mali i Zi dhe Peruja ndodheshin ne kete situate.


Nje situatë e ngjashme konstatohet edhe për furnizimin me ujë. Në analizën e 59 vendeve, ku niveli mesatar global i aksesit në ujë të menaxhuar në mënyrë të sigurt ishte rreth 74.3% në vitin 2020, Shqipëria dhe Peruja shpenzonin më shumë se niveli i vlerësuar i nevojshëm, por vazhdonin të kishin akses relativisht të ulët. Në të kundërt, Mali i Zi dhe Bullgaria kombinonin shpenzime të mjaftueshme me akses mbi mesataren.

Banka Botërore vëren se shpenzimet më të larta mund të tregojnë se vendet po financojnë në mënyrë aktive zgjerimin e rrjetit dhe përmirësimin e shërbimeve. Por raporti ngre edhe një mundësi tjetër, shpenzimet e larta të mos përkthehen proporcionalisht në rezultate për shkak të eficiencës së ulët të investimeve. Sipas raportit, niveli i shpenzimeve nuk është domosdoshmërisht tregues i cilësisë apo i rezultateve të arritura.

Edhe vlerësimet për peshën e shpenzimeve në ekonomi e veçojnë Shqipërinë në rajon. Banka Botërore përlogarit se shpenzimet totale për sektorin e ujit në Shqipëri arrijnë në rreth 0.88% të PBB-së, nga të cilat 0.73% e PBB-së janë shpenzime kapitale. Vetëm për furnizimin me ujë dhe kanalizimet (WSS), shpenzimet totale vlerësohen në 0.66% të PBB-së, ndërsa investimet kapitale në 0.57% të PBB-së.

Këto nivele janë më të larta se në pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor të përfshirë në të njëjtën tabelë. Shpenzimet totale për sektorin e ujit vlerësohen në rreth 0.60% të PBB-së në Malin e Zi, 0.35% në Bosnjë-Hercegovinë, 0.31% në Serbi, 0.23% në Maqedoninë e Veriut dhe vetëm 0.11% në Kosovë.

Në periudhën 2009-2020, Shqipëria realizoi mesatarisht rreth 80% të fondeve të buxhetuara për sektorin e ujit, që nënkupton se rreth një e pesta e fondeve të planifikuara nuk u ekzekutuan. Norma ishte më e lartë se mesatarja globale prej rreth 72% që raporti llogarit për sektorin e ujit. Rasti i Shqipërisë është në kontrast me problemin kryesor që Banka Botërore konstaton në shumicën e vendeve./Monitor





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Gjykata lë në burg kushëririn e Agasit, dosja i kalon SPAK-ut

Zjarr në malin e Moravës

“Agro Invest Korça” pjesë e “Serenights Festival”/ Spiro Fuqi për CNA: Viojmë traditën e kulinarisë korçare

Ngërçi me pagat e magjistratëve/ SPAK merr në pyetje drejtoreshën e Thesarit

“Erion Veliaj, piramidë krimi elektoral”/ Berisha: Ka një luftë të madhe mes tij dhe Ramës

“Qëndron pas aferës 130 milionë euro”/ Berisha: Nëse ka një njeri që prish provat është Erion Veliaj

Berisha për Zvërnecin: Është dhënë leje ndërtimi pa respektuar ligjin

Heqja e non gratës/ Berisha: Zgjedha gjykatën për të mbrojtur dinjitetin tim

110 ditë protestë/ Qytetarët përpara Komisaritit 1

Berisha: Ja çfarë do u thojë ish krerëve të UÇK-së

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Berisha zbulon kërkesën që i bëri Hillary Clinton

Ngritja e gjykatës speciale të Kosovës/ Berisha: Rama fluturoi me helikopter për të përcaktuar votimin

Dita e 110 e protestës/ Qytetarja: Para Parlamentit dhunë si ajo e Zvërnecit

Pagat e magjistratëve/ SPAK nis hetimet, sekuestrohen praktikat te Ministria e Financave

Interpelanca për bypassin e Elbasanit/ Karakaçi: Kosto 240 mln euro, në fokus reduktimi i trafikut

Këlliçi ironizon Nufin: Rri i qetë “Raketë”, ty biletën Tiranë-Durrës do ta paguaj unë

Aeroporti i Vlorës/ Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s

Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve: Të respektohet vendimi i Kushtetueses

Audiopërgjimet e Ahmetajt/ Këlliçi zbardh aferën, si u morën 30 milionë euro nga taksat e shqiptarëve


Deklarata e Kuvendit për vendimin e Hagës/ Këlliçi: Manovër për t'u hedhur hi në sy shqiptarëve

[editorial](#)

19:39 Editorial

Burri Hashim Thaçi dhe burreci Veliaj

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

09:14 Opinione Besim Ndrejoni

Bojkotoni takimet me politikanët e Shqipërisë që mbajnë peng demokracinë!

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

17:17 Opinione Elvi FUNDO

Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit

Lifestyle

07:38 Lifestyle

Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

20:40 Lifestyle

Si të shmangni shpërthimin e pijeve të gazuara? Ja një truk i thjeshtë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.